



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:243787
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06184421

C-IV-14-3190

Ankuesi

T D, Kurshumlija, R.Serbise

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, AL per NSH “Sloga –KHT Kosova” (ne likuidim) Rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 18 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** ankesa si e pabazuar
- II. VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN124-1409 i datës 06 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- III. Nuk caktohen** taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 24 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN124-1409, të datës 06 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, (shkurt AL) me të cilin ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara, për periudhën kohore nga qershori i vitit 1999, deri në maj 2007 në shumë të pacaktuar, nga NSH “Sloga-KHT Kosova ” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se paraqet ankesë kundër vendimit të komisionit të AL-së të AKP-së dh se është i pakënaqur me vendimin që është marr kundër tij, për punën që ka bërë në NSH. Gjithashtu ankuesi pohon se organi administrativ i shkallës së parë nuk e ka zhvilluar procedurën në mënyrën e duhur, as nuk ka marrë parasysh faktet dhe provat që kam paraqitur dhe se nuk ka marrë një vendim të drejt e ligjor, andaj e kundërshtoi vendimin e AL-së si të pabazuar në ligj

dhe të padrejtë për mua. Andaj kërkoi nga Dhoma e Posaçme që ta anuloi vendimi e AL-së, si të gabuar dhe jo i drejtë dhe të rivendosë ndryshe në favor të ankuesit. Në mbështetje të ankesës dorëzoi kopjen e vendimit të kundërshtuar të AL-së.

Me 28 shkurt 2023, e paditura parashtroi mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Po ashtu e paditura pohoi se dëshiron të sqaroj se pagesa e rrogave nga NSH nuk përmban asistencë sociale, ndihmë filantropike apo atribut natyror. Në fakt paga është kompensim për punën e kryer, në zbatim të një kontrate dypalëshe përmes së cilës rregullohen të drejtat e tyre si dhe palët përmbushin detyrimet që rrjedhin nga e njëjta. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara, dëshmi se ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën e kërkuar, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, në shumë të pacaktuar, për periudhë kohore nga qershori i vitit 1999, deri në maj të vitit 2007, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara dhe njëherit të parashkuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit nuk është caktuar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-14-3190

Podnosilac žalbe

T D, Kuršumlija ,Srbija

Protiv

Tužena

Kosovske Agencije za Privatizaciju, OL za DP “Sloga KHT Kosova” , ul. “Dritan Hoxha ”, nr.55, Priština.

Posebna komora Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju (Posebna Komora), sudija Diellza Hoxha, dana 18 septembra 2024 godine je donela ovu:

P R E S U D U

- 1. Žalba se ODBIJA kao neosnovana**
- 2. POTVRĐUJE se Odluka Organa za likvidaciju, PRN124-1409 od 6 marta 2014 godine, kao pravična i zasnovana na zakonu.**
- 3. Žaliocu se ne određuju sudski troškovi .**

Činjenične i proceduralne okolnosti

Žalilac je 24 aprila 2014. godine podneo Posebnoj Komori žalbu na rešenje br. PRN124-1409 od 06 marta 2014. godine Organa za likvidaciju- Kosovske Agencije za Privatizaciju, kojim je odbijen zahtev za naknadu neisplaćene zarade, za period od juna 1999. do maja 2007. godine, u neodređenom iznosu.od DP „Sloga –KHT Kosova ” (u likvidaciji).

Žalioc je tvrdio da podnosi žalbu na odluku OL komisije KAP i da je nezadovoljan odlukom koja je doneta protiv njega, za rad koji je obavljao u DP-u. Žalioc takođe tvrdi da prvostepeni organ nije na pravi način vodio postupak, niti je uzeo u obzir činjenice i dokaze koje sam izneo da nije doneo pravičnu i zakonitu odluku, što zbog njegova diskriminatorna priroda, krši moja

ljudska i imovinska prava. Stoga je zatražio od Posebne Komore da poništi odluku OL-a, kao pogrešnu i nepravičnu, i da u suprotnom vrati u njegovu korist.

U prilog žalbe priložio je kopiju osporenog rešenja

Tužena je 28 februara 2023. godine podnela odbranu u kojoj je tvrdila da je OL izvršila tačnu procenu činjeničnog stanja i da su zakonske odredbe precizno sprovedene. Tužena je tvrdila da je zahtev žalioaca zastareo na osnovu člana 608 Ujedinjenog Zakona o radu. Tužena je takođe izjavila da želi da pojasni da isplata plata od strane DP-a ne sadrži socijalnu pomoć, filantropsku pomoć ili prirodnu atribuciju. U stvari, plata je naknada za obavljeni posao, u okviru bilateralnog ugovora kojim se regulišu njihova prava, a stranke ispunjavaju obaveze iz istog. Tužena je predložila da se tužba odbije kao neosnovana i da se osporeno rešenje potvrdi.

Pravno obrazloženje

Žalba se odbija kao neosnovana.

Na osnovu člana 2.4 i člana 77.1.1.1 Zakona br. 06-L-086 o Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju (Zakon o Specijalnoj komori), sud će sprovesti proceduralne odredbe ovog zakona.

U skladu sa članom 76.3 Zakona o Posebnoj komori, u vezi sa članom 399. Zakona o parničnom postupku, Sud nalazi da činjenice sadržane u žalbi ne potkrepljuju je i donosi ovu presudu bez zakazivanja rasprave.

Član 42 tacka 2 Zakona o Specijalnoj Komori predviđa da stranka koja tvrdi činjenicu ili događaj ima teret dokazivanja da dokaže istinitost takve tvrdnje ,podnošenjem podnesaka ili iznošenjem materialnih dokaza(dokumentovani fizički i/ili dokazi). Dok tacka 3 predviđada stranka koja zahteva činjenicu ili događaj imaju razumnu priliku da izvedu ili podnesu materialne dokaze u prilog takvoj tvrdnji, ako takva stranka ne uspe da izvede ili dostavi takve dokaze onda se smatra da stranka nije obezbedila teret dokazivanja u vezi takve tvrdnje .

Prem članu 7 Zakona o Parničnom Postupku stranke su dužne da iznesu sve činjenice koje potkrepljuju njihove tvrdnje i da predlaže dokaze kojima se takve činjenice utvrđuju. Drugim rečima svako ko nešto kaže mora to da dokaže (ie incumbit probatio que dicit).

U ovom slučaju, sud nalazi da činjenica da je žalioac bio radnik DP-a nije sporna, ali na osnovu spisa predmeta, sud zaključuje da žalioac nije pružio nijedan relevantan dokaz koji dokazuje da DP duguje tražene plate, dokaz da je pružao usluge rada za DP za tražen period , žalioac nije pružio nikakav dokaz u vezi obračuna traženih plata.

Sud nalazi da, u nedostatku relevantnih dokaza, tvrdnje žalioca u pogledu njegovog prava na naknadu za neisplaćenu zaradu, u neutvrđenom iznosu, za period od juna 1999. godine do maja 2007. godine, nisu potkrepljene potrebnim materijalnim dokazima. , pa se kao takvi odbacuju kao neosnovani i istovremeno propisani.

Dakle, na osnovu navedenog iu skladu sa članovima 54.1 i 74.4 Zakona o Posebnoj Komori, odlučeno je kao u dispozitivu presude.

Sudske takse

Na osnovu člana 62.5 Zakona o Posebnoj Komori, svaka stranka snosi svoje troškove. U skladu sa članom 13.3 Administrativnog uputstva za ujednačavanje pravosudnih poreza, Sudskog saveta Kosova (KJK) br. 01/2017, od 22.03.2017.godine, u ovom žalbenom postupku nisu utvrđene sudske takse, jer nije utvrđena vrednost spora.

Pravni saveti

Protiv ove presude može se podnijeti pismena žalba Apelacionom kolegijumu Posebne komore u roku od 15 dana od dana prijema ove presude. Žalba se podnosi na osnovu člana 9.6 Zakona o Posebnoj komori.

Diellza Hoxha
Sudija